

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE E QARKUT TIRANË
SHKOLLA 9-VJEÇARE BERZHITE

Nr 412 Prot

Tiranë, më 22.05.2015

NJOFTIM PËR KONKURIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Shkolla 9-vjeçare Berzhite, Tiranë, në zbatim të Ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimit Nr.35, datë 30.09.2014 "Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar", shpall njoftimin e kërkesave për konkurim, për vendin e lirë të punës në pozicionin **Mësues të Ciklit Fillor** të:

1. Shkolla 9-vjeçare Berzhite, Tiranë. Të gjithë mësuesit e këtij profili (profili Cikli Fillor) të interesuar për këtë pozicion pune (**Mësues Cikli Fillor**), duhet të paraqesin pranë drejtorisë së Shkollës 9-vjeçare Berzhite, Tiranë, dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Diplomë të ciklit të dytë të studimeve të shtatë, sipas përcaktimeve të nenit 57 të Ligjit Nr.69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", (fotokopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave të shkollës së lartë).
 - b) CV dhe kopje të dëshmimeve apo dokumente që vërtetojnë pohimet në CV (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën Nr 1, bashkëlidhur Udhëzimit Nr.35, datë 30.09.2014).
 - c) Tabelën e të dhënave për aplikant (Sipas modelit të përcaktuar në shtojcën Nr. 2, bashkëlidhur Udhëzimit Nr.35, datë 30.09.2014).
 - d) Raportin mjeko - ligjor.
 - e) Dëshminë e masave disiplinore në fuqi në ngarkim të tij. (Nëse nuk ka e deklaron me shkrim që nuk ka).
 - f) Dëshminë e penalitetit, të lëshuar jo më herët se tre muaj para datës së aplikimit.
- Dorëzimi i dokumentacionit të aplikimit për konkurim, do të bëhet pranë drejtorisë së Shkollës 9-vjeçare Berzhite, Tiranë, me adrese fshati Berzhite, çdo ditë nga ora 08:00 – 14:00.
- Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të aplikimit për konkurim, do të jetë data 01.06.2015 ora 14⁰⁰.
- Dokumentacioni për aplikim dorëzohet në dëshminë e Shkollës 9-vjeçare Berzhite, Tiranë, me procesverbal dorëzimi.

DREJTOR
BEQIR HONAJ

